



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Kom.Dh.shk.II.nr.283/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Trendy Home shpk me seli në Lubizhdë Komuna e Prizrenit, tani suksesor juridik i firmës Gold Invest shpk me seli në Lubizhdë Komuna e Prizrenit me pronar M.L., i përfaqësuar sipas autorizimit nga A.H. avokat në Prizren, kundër debitorit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me adresë ish pallati i mediave Rilindja në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, për shkak të pagesës së borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësueses së autorizuar të debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.3324/20 të datës 13.12.2021, me datë 20.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.3324/20 i datës 13.12.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.3324/2020 të datës 13.12.2021, ka vendosur si në vijim: I Aprovohet pjesërisht i bazuar, prapësimi i Ministris së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, dhe shfuqizohet urdhri mbi caktimin e përmbartimit P.nr.504/20 dt.11.11.2020 të përmbartuesit privat Mehdi Reshani si organ përmbartues, në pjesën që ka të bëjë me kamatë vonesën 8% nga data e faturimit të secilës faturë e deri në pagesën definitive, II Refuzohet i pabazuar prapësimi i Ministris së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, sa i përket kërkesës objekt i përmbartimit në shumën prej 9,987.52€ dhe për këtë shumë dhe për shpenzimet e procedurës së përmbartimit të cilat përfundimisht përlllogariten nga organi përmbartues, urdhri mbi caktimin e përmbartimit P.nr.504/20 dt.11.11.2020, mbetet në fuqi

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesja e debitorit Avokatura Shtetërore – Ministria e Drejtësisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit si e bazuar, dhe të Priset aktvendimi PPP.nr.3324/2020 të datës 13.12.2021, si i kundërligjshëm.

Dhomat e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Trendy Home shpk me seli në Lubizhdë Komuna e Prizrenit, tani suksesor juridik i formës Gold Invest shpk me seli në Lubizhdë Komuna e Prizrenit me pronar M.L., me datën 11.11.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave nr.-134/18 dt.24.10.2018, 0133/18 dt.20.11.2018, 0135/18 dt.21.11.2018, 0136/18 dt.21.11.2018, 158/18 dt.23.11.2018, 159/18 dt.23.11.2018, 0161/18 dt.26.11.2018, 0162/18 dt.26.11.2018. Përmbartuesi privat Mehdi S. Reshani, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.504/20 të dt.11.11.2020, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori duke urdhëruar debitorin që ti, a paguaj kreditorit në emër të borxhit shumë prej 9,987.52€ me kamatë vonesë prej 8% nga data e faturimit të secilës faturë e deri në pagesën definitive.

Përfaqësuesja e autorizuar e debitorit e kundërshton në tërsi si të pabazuar urdhrin përmbartimor, dhe në seancën gjyqësore e ka kundërshtuar caktimin e përmbartimit me arsyetimin se debitorin sipas raportit ditor të certifikimit nga dt.05.04.2019 deri me dt.08.04.2019 dhe urdhrin për pagese të dt.08.04.2019, përmes SIMFK, ka dërguar ekzekutimin e detyrimit kreditorit Gold Invest shpk me dt.08.04.2019 mirëpo sipas raportit të Thesarit të Kosovës dt.12.04.2019 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me dt.12.04.2019 e ka anuluar pagesën, pasi nga moskujdesi i kreditorit pagesa është kthyer për shkak që llogaria e kreditorit ka qenë jo aktive, për shkak të ndërrimit të emrit nga Gold Invest shpk në Trendy Home shpk, andaj kreditori ka qenë i obliguar ta njoftoi debitorin me rastin e ndërrimit të emrit dhe të llogarisë me rastin e sjelljes se faturës për pagesë, mbështetur në të thënat si në prapësim dhe në seancën dëgjimore, i propozon gjykatës të aprovohet i bazuar prapësimi i debitorit, dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Përgjigje në prapësim dhe në seancën dëgjimore, kreditori, kundërshton si të pabazuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se fakti mbi ekzistimin e borxhit pohohet edhe nga vet debitorin ndërsa arsyetimi se pagesa është kthyer për shkak që llogaria e debitorit ka qenë joaktive nuk qëndron, pasi kreditori ka bërë vetëm ndryshimin e emrit të subjektit afarist për qka është njoftuar debitorin,

por kreditori nuk ka bërë ndryshimin e llogarisë bankare, kreditori pranon pagesa dhe bën pagesa në të njëjtën llogari bankare me nr.1502040000685476 në RBKO, ndërsa debitori asnjëherë nuk ka kërkuar ndonjë sqarim nga kreditori lidhur me pretendime e tij lidhur me llogarinë bankare, i propozon gjykatës që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë– Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, përgjigjen në prapësim të kreditorit, dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, në seancën dëgjimore, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.3324/20 të datës 13.12.2021, me të cilin e ka Aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se vonesa e debitorit në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit ka ardh me fajin e kreditorit për shkak se nuk e ka njoftuar debitorin për ndryshimet e bëra në emrin e biznesit, për pasojë urdhërpagesa për përmbushjen e detyrimit nga debitori në dobi të kreditorit në shumën e kërkuar 9,987.52€, është kthyer mbrapa nga BQK dhe bankat afariste, për arsye të llogaris jo të saktë apo emrit të përfituesit-kreditorit. Gjykata vlerësoi se dokumentet e besueshme-faturat mbi bazën e të cilave është caktuar përmbarimi, i plotësojnë të gjitha kushtet kumulativisht për të shërbyer si bazë juridike dhe titull ekzekutiv për caktimin e përmbarimit në pajtim me nenin 21 dhe 29 par.1.3 të LPP-së, pasi në to është treguar kreditori, debitori, objekti, lloji shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e cila kohë sipas nenit 18 par.2 të kontratës tek Parimet e Përgjithshme të pagesave parashihet jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar në departamentin përkatës, faturat janë pranuar nga debitori, ndërsa me parashitjen e datës 23.11.20121 të cilës i ka bashkangjitur në kopje të noterizuar Historinë e biznesit, të lëshuar nga ARBK, debitori e ka njoftuar gjykatën për ndryshimet në emrin e biznesit, ashtu që emri i biznesit nga Gold Invest shpk me date 12.04.2019 ndryshon në Trendy Home shpk, rrjedhimisht kredia në pajtim me nenin 13 të LPP-së, në bazë të dokumentit zyrtar ka kaluar tek kreditori Trendy Home shpk.

Gjykata e Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti të Përgjithshëm, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e tillë lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar edhe gjendja faktike, shkelje të cilat Gjykata Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore të përfaqësueses së autorizuar të palës debitore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, ka vendosur drejtë si në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbartimore, përkatësisht neni 29 par 1. nën par.1.3 dhe par 3 i cili përcakton se: “*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: fatura. Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerësoi se faturat mbi bazën e të cilave është caktuar përmbartimi, paraqet dokument të besueshëm dhe është e përshatshme për përmbartim. Prandaj në këtë rast rezulton se në këtë çështje përmbartimore nga fatura e larte cekura, debitori ka mbetur në detyrim ndaj kreditorit nga faturat në fjale në shumën prej 9,987.52€.

Ndërsa më nenin Neni 37 përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”, në këtë rast duke pasur parasysh se faturat janë origjinale dhe i plotësojnë kushtet për përmbartim, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Dhomat e shkallës së dytë vlerësoi se me të drejt gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pikën një të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, pasi që vonesa e debitorit në përmbushjen e detyrimit ka ardh me fajin e kreditorit, për shkak se nuk është njoftuar debitori për ndryshimet e bëra në emrin e biznesit.

Pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se kreditori nuk ka pasur llogari të sakta lidhur me faturat e dorëzuara apo emrin e përfituesit dhe se mjetet janë kthyer nga BQK dhe bankat afariste për arsye të llogarive jo të sakta apo edhe numrit të përfituesit, Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi të pamjaftueshme këto pretendime për të ndryshuar aktvendimin e atakuar, sepse gjykata e shkallës së parë ka dhënë përgjigje lidhur me këtë pretendim të cilën e pranon e dhe kjo gjykatë, duke u referuar në dispozitën e nenit 31 par. 1 të LPP-së, se kreditori ka dëshmuar kopjen e noterizuar dt.18.11.2021 të historisë së biznesit e lëshuar nga ARBK-së, për ndryshimin e emrit të biznesit, dhe në anën tjetër të Kontrata publike kornize neni 18 par.2 e lidhur mes dy palëve ndërgjyqëse për furnizim me orendi shtëpiake për familjet e riatdhesuara nga vendet e BE, parashihet afati i pagesës jo më shumë se 30 ditë kalendarike

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e shkallës së dytë  
Kom.Dh.shk.II.nr.283/23 me datë 20.07.2023

Gjyqtari,  
Krenar Berisha